



Munich Personal RePEc Archive

Social Market Economy as an alternative to the Washington Consensus in the Western Balkans

Matoshi, Ruzhdi and Mulaj, Isa

State University of Tetovo

2019

Online at <https://mpra.ub.uni-muenchen.de/102256/>
MPRA Paper No. 102256, posted 18 Aug 2020 13:33 UTC

Ekonomia Sociale e Tregut si alternativë e Konsensusit të Uashingtonit në Ballkanin Perëndimor

Ruzhdi Matoshi ¹⁾, Isa Mulaj ²⁾

¹⁾Ligjërues në kolegjin UBT
Prishtinë, Republika e Kosovës

e-mail: rmatoshi@ubt-uni.net, matoshi.r@gmail.com

²⁾Hulumtues i lartë në Institutin për Hulumtime dhe Analiza të Politikave Ekonomike
Prishtinë, Republika e Kosovës
e-mail: isa.mulaj@gmail.com

Përmbledhje

Pas gati tri decenieve që nga fillimi i transicionit nga komunizmi për në demokraci dhe ekonomi të hapur të tregut në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL), Konsensusi i Uashingtonit në përgjithësi e merr notën si dështim. Gjersa përvoja nga EQL përveç rezultateve të përbashkëta tregon ndryshime të konsiderueshme, pakoja e reformave është diskutabile edhe në perspektivën afatgjatë, sidomos për shkak se prodhon kosto të lartë sociale. Emigrimet masive kohëve të fundit nga Ballkani Perëndimor për shkak të kushteve të dobëta ekonomike dhe nga Lindja e Mesme, e kanë rritur vëmendjen rreth kredibilitetit për eksportimin ose imponimin e demokracisë Amerikane, e së bashku me të, edhe Konsensusin e Uashingtonit si model të transformimit dhe zhvillimit ekonomik. Por a ekziston ndonjë alternativë? Pothuajse ka ekzistuar edhe para se të fillojnë ndryshime sistimore në EQL, dhe ajo mund të jetë më e parapëlqyer edhe tani për vendet të cilat ende kanë për të bërë transformime të konsiderueshme ekonomike. Ajo është Ekonomia Sociale e Tregut, modeli i së cilës ende mund të zbatohet në disa vende që kanë mbetur prapa në transicion. Ky punim shtjellon perspektivën e futjes dhe zbatimit të këtij modeli në vendet e Ballkanit Perëndimor, me theks të posaçëm në rolin e shtetit, tatimeve, shpërndarjes së të ardhurave dhe zhvillimit të biznesit.

Fjalët kyçe: Konsensusi i Uashingtonit, Ekonomia Sociale e Tregut, Ballkani Perëndimor, reformat ekonomike.

Shënim për lexuesin: Ky punim është përkthim nga gjuha angleze, prandaj, nëse synohet të përdoret për citim, referenca e saktë është: Matoshi, Ruzhdi and Mulaj, Isa (2019), "Social Market Economy as an Alternative to the Washington Consensus in the Western Balkans", *Economic Vision*, Vol. 6, No. 11-12, pp. 180-191.

Social Market Economy as an alternative to the Washington Consensus in the Western Balkans

Ruzhdi Matoshi ¹⁾, Isa Mulaj ²⁾

¹⁾ Department of Economics, Faculty of Economics, UBT College, Republic of Kosovo
²⁾ Department of Economic Research, Institute for Economic Policy Research and Analyses, Republic of Kosovo
*Corresponding Author: e-mail: rmatoshi@ubt-uni.net

Abstract

Nearly three decades after the beginning of transition from communism to democracy and open market economy in Central and Eastern Europe (CEE), the Washington Consensus in general received the mark as a failure. While the experience from the CEE apart from common results showed considerable variations, the package of reforms is questioned even in the long-term perspective, especially for producing high social costs. Recent mass emigrations from the Western Balkans due to poor economic conditions and from the Middle East, have brought to attention the credibility of exporting or imposing the American type of democracy, and with it, the Washington Consensus as a model of economic transformation and development. But is there an alternative? It already existed even before the systemic changes in CEE began, and can be more preferable even now to the countries that have to undergo a considerable economic transformation. That is the social market economy, which still can be applied in some countries that have lagged behind in transition. This paper explored the perspective of introducing and implementing such a model in the Western Balkan countries, with a reference to the role by the state, taxes, income distribution, and business development.

Keywords: Washington Consensus, Social Market Economy, Western Balkans, economic reforms.

A note to the reader: This is a translated paper from English, therefore, to quote it, use the reference from the English version: Matoshi, Ruzhdi and Mulaj, Isa (2019), "Social Market Economy as an Alternative to the Washington Consensus in the Western Balkans", *Economic Vision*, Vol. 6, No. 11-12, pp. 180-191.

1. Premtimi dhe dështimet e Konsensusit të Uashingtonit

Konsensusi i Uashingtonit ishte (dhe ende është) pako e reformave ekonomike e rekomanduar dhe ofruar si model për vendet në zhvillim, më së shumti për ato që dolën pas rënies së komunizmit në EQL. Politikat e këtyre reformave përfshinin tri institucione: Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), Bankën Botërore, dhe Departamentin e Thesarit të SHBA-së. Që të tria, dy prej të cilave janë ndërkombëtare dhe një nga ekonomia më e madhe kombëtare, e kanë selinë në Uashington D.C., kryeqyteti i SHBA-së. Nuk ka mundur të quhet ndryshe, pavarësisht se Uilliëmson mund të cilësohet se e ka formësuar këtë term.¹ Në parim, Konsensusi i Uashingtonit përbëhej nga këto dhjetë rekomandime mbi politikat e reformave për vendet në zhvillim:

- 1) Disciplina e politikës fiskale e përqendruar në deficitin e ultë fiskal në raport me Bruto Produktin Vendor (BPV);
- 2) Ulja dhe ridrejtimi i shpenzimeve publike kah sektorët me rritje më premtuese për të varfërit siç janë arsimimi, kujdesi shendetësor, dhe investimet në infrastrukturë;
- 3) Reforma e tatimeve duke zbatuar norma margjinale të moderuara dhe zgjerimi i bazës tatimore;
- 4) Norma pozitive të kamatës që i përcakton tregu, të cilat priten të jenë të moderuara sipas kushteve të tregut;
- 5) Norma konkurruese në shkëmbimin e valutave;
- 6) Liberalizimi i tregtisë me theks të importit, duke përfshirë eliminimin e kuotave sasiore, ndërkaq, çdo proteksionizëm tregtar duhet t'i nënshtrohet tarifave uniforme dhe relativisht të ulëta;
- 7) Liberalizimi i investimeve të huaja direkte;
- 8) Privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore;
- 9) Derregullimi, d.m.th. eliminimi i rregullave që i pengojnë hyrjet e reja në treg ose e kufizojnë konkurrencën, përveç atyre që arsyetohen me çështjen e sigurisë, mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit, si dhe mbikëqyerja e kujdesshme e institucioneve financiare; dhe
- 10) Mbrojtja ligjore e të drejtave pronësore.

¹ I pari që e ka përdorur termin “Konsensusi i Uashingtonit” ishte Williamson, John (1990), “What Washington Means by Policy Reform?”, in Williamson, John ed., *Latin American Adjustment: How Much has Happened?*, Washington DC.: Institute for International Economics, pp.7-20.

Se çfarë ndikimi dhe rezultati ka prodhuar Konsensusi i Uashingtonit në vendet e EQL, kjo do të diskutohet më vonë. Në vështrim sipërfaqësor, rezultatet gjatë pothuajse tërë decenies së 1990 për shumicën e vendeve që e zbatuan pakon e këtyre reformave, ishin treguar me rënie ekonomike, diku në shkallë më të lartë e tjetërkund më të ulët. A ishte kjo rënie ekonomike e domosdoshme në rrugën më të gjatë drejt rritjes, ashtu që reformat do të mund të gjykoheshin si të suksesshme? Realisht, jo. Ishte një befasi e cila i detyroj shumë ekonomistë ta kritikojnë Konsensusin e Uashingtonit si model i dështuar për transicion nga ekonomia e centralizuar komuniste në atë të ekonomisë së tregut. Në mesin e tyre, Joseph Stiglitz, e arsyetonte kritikën duke u bazuar në përvojën e tij si krye-ekonomist i Bankës Botërore, se modeli i tillë ka sjellë shumë vuajtje të qëllimshme ose të papritura jo vetëm në EQL, por edhe në disa vende të Afrikës dhe Azisë ku ishte zbatuar.² E njëjta pako e reformave për transicion ekonomik është zbatuar në vendet e Ballkanit Perëndimor, i cili ishte i përcjellur me luftëra civile, duke e bërë transicionin më të vështirë. Vështirësitë e njëkohshme nga luftërat civile që ndikuan në shpërbërjen e ish-Jugosllavisë dhe rënia e komunizmit, i detyroj secilin nga shtetet rishtas të krijuara ta zgjedhin rrugën e tyre të reformave ekonomike nën udhëzimet e Konsensusit të Uashingtonit. Nuk ekzistonte ndonjë strategji e elaboruar ose e hollësishme se si të vazhdohet dhe cilat mund të jenë rezultatet e rrugës së zgjedhur.

Sikur në shumicën e vendeve të EQL, edhe në Ballkanin Perëndimor (i cili po ashtu është pjesë e EQL) u shfaqen dy ide ose propozime për transicion ekonomik. I pari ishte i njohur si transicion i shpejtë ose “shok terapi”, dhe i dyti si “qasja graduale”. Dallimi kyç ndërmjet këtyre dy strategjive mund të përmblihet si vijon: përkrahësit e të parës ishin të shqetësuar se vonesa në liberalizim dhe satabilizim mund të shpie në praktika të haraçit dhe krijimin e grupeve për t’i kundërshtuar reformat me përfitime të gjëra ose të ndikojnë në dështimin e tyre. Në arsyetimin e tyre, ithtarët e propozimit të parë pajtoheshin se institucionet ishin të nevojshme por jo të domosdoshme para se të ndërmerren reformat. Përkrahësit e qasjes graduale kishin frikën se lëvizjet e shpejta mund të përcillen me çrregullime të mëdha, dhe të shkaktojnë humbje të mëdha në mirëqënien ekonomike të qytetarëve. Për dallim nga shok terapistët, garadualistët së pari i vënin institucionet para liberalizimit dhe stabilizimit ekonomik. Në përgjithësi, alternativa e “shok terapisë” sipas botëkuptimit të Havrylyshyn është dëshmuar si më e suksesshme. Kjo ishte zbatuar në shtetet Baltike, Poloni, Republikën Çeke dhe Sllovaki, ndërkaq Shqipëria, Bullgaria,

² Stiglitz, Joseph (2002), *Globalization and Its Discontents*, London: Penguin Books.

Maqedonia, Kirgistani, dhe Rusia e kishin braktisuar këtë. Qasja graduale u zbatua në Azerbejxhan, Armeni, Gjeorgji, Kazahstan, Ukrainë, Taxhikistan, dhe Rumani.³ Shumica e vendeve kanë hyrë në procesin e transicionit në “shok terapi” përmes liberalizimit të çmimeve. Inflacioni ishte ose i pranishëm, ose kërcënim i madh. Duke filluar me Poloninë në 1990, pakoja e stabilizimit monetar deri më 1995 ishte fuqizuar në 25 vende. Normat vjetore të inflacionit para stabilizimit ndryshonin shumë: nga hipërinflacioni prej 57 000 për qind në Gjeorgji te 26 për qind në Hungari. Kjo gjendje e dëmtonte dukshëm suksesin e reformave. Bullgaria, Estonia, dhe Lituania i kishin normat më të ulëta mbresëlënëse të inflacionit. Koha po ashtu kishte rëndësi meqenëse reformuesit e më hershëm ishin më të suksesshëm se ata të mëvonshëm.⁴

Rezultateve se “shok terapia” ishte më e suksesshme në disa vende se në tjerat të cilat e zbatuan “qasjen graduale” duhet t’u rikujtohet se kushtet fillestare të transicionit nuk ishin të njëjta. Polonia, Republika Çeke, Sllovakia, dhe shtetet Baltike ishin gjeografikisht më afër vendeve të zhvilluara kapitaliste (vendeve Skandinave dhe Gjermanisë), çka ndikoj në marrëdhëniet më të shpejta ekonomike ndërmjet tyre siç janë lëvizja më e madhe e kapitalit, shpenzime më të ulëta të shkëmbimeve tregtare, kështu që këto vende ishin në portat e vendeve të zhvilluara. Këto pra, ishin ndër faktorët kryesor që ndikuan në rezultatet e ndryshme duke e bërë transicionin më të suksesshmëm në disa vende se në tjerat. Për disa të tjera do të diskutohet shkurtimisht në nëntitullin që vijon.

³ Havrylyshyn, Oleh (2007), “Fifteen Years of Transformation in Post-Communist World: Rapid Reformers Outperformed Gradualists”, CATO Institute, Discussion Paper No. 4.

⁴ Fisher, Stanley and Sahay, Ratna (2000), “The Transition Economies after Ten Years”, Cambridge: National Bureau of Economic Research, Working Paper No. 7664.

2. Dështimet e Konsensusit të Uashingtonit në Evropën Qendrore dhe Lindore

Transicioni në EQL ishte unik nga shumica e vendeve tjera të botës meqenëse përfshinte ndryshimet sistemore si në politikë ashtu edhe në ekonomi. Sistemi një partiak ishte braktisur në favor të pluralizmit politik ose demokracisë. Por, çfarë lloji i demokracisë? Demokracia jo domosdoshmërisht nënkupton shumë parti politike. Partia komuniste poashtu mund të cilësohej demokratike pasi lejonte të gjithë votuesit të vendosin se cilin kandidat ta votojnë. Mirëpo, dallimi qëndron në atë se komunizmi nuk lejonte opozitë politike, e së bashku me të, as alternativë ose opozitë ndaj reformave në ekonomi. Ideologjia e partisë dhe prona shtetërore mbi mjetet e prodhimit mbaheshin si gurëthemel i sistemit.

Planifikimi qendror ishte sistem jo efikas dhe i dyshimt në afat të gjatë. Interesi i pushtetit komunist ishte të raportoj përmbushjen e planeve në shkallë më të lartë se sa aktualisht realizoheshin. Kjo filloj të bëhet e qartë kur filloj rënia e komunizmit dhe nisja e transicionit ku, statistikave e fryera nuk i përgjigjeshin gjendjes në terren që përballej me mungesa, duke përfshirë edhe artikujt ushqimorë. Deri në fundin e periudhës komuniste, prodhimi ishte duke rënë thuajse në çdo regjim komunist të tipit sovjetik, rënie e cila u shpejtua në vitin e parë të transicionit dhe vazhdoi në vitet vijuese. Polonia ishte vendi i parë që e ndali këtë trend të rritjes ekonomike negative, kurse Ukraina ishte në gjendje ta bëjë një gjë të tillë vetëm pas tetë vite të rënies ekonomike. Rënia e përgjithshme e BPV-së në Republikën Çeke arriti 13% nga 1989 deri më 1992, deri në 77% në Gjeorgji ndërmjet 1989 dhe 1994 ose më e madhe se në vendet e industrializuara gjatë Depresionit të Madh 1929-1933. Rënia mesatare e BPV-së e regjistruar në EQL ndërmjet viteve 1989 dhe 1992 ishte 17%. Nga vitit 1989 deri më 1997, rënia sillej nga 30% në Bullgari dhe Rumani, deri në 40% në vendet e ish-Bashkimit Sovjetik.⁵ Pesë vende (Armenia, Azerbejxhani, Gjeorgjia, Taxhikistani, dhe deri-diku Molldavia) vuanin nga luftërat qytetare dhe konfliktet etnike, por rënia e madhe e BPV-së në vendet tjera ishte e pazakonshme për kohën e paqes. Ka qenë kjo rënie gjatë transicionit ekonomik e cila i zuri në befasi ose të papërgatitur shumicën e ekonomistëve rreth teorive të transformimit ekonomik nga ekonomia me planifikim centralist tek ajo e hapur dhe me orinetim tregu.

⁵ Aslund, Anders (2000), "The Myth of Output Collapse after Communism", Washington D.C.: Carnegie Endowment for International Peace.

Rënia gjatë transicionit përkoj me intensitetin e reformave strukturore. Imponimi i kufizimeve të forta buxhetore dhe shkurtimi i subvencioneve në shkallë të gjërë goditi shumë sektorë. Ekzistonin shenjat e çrregullimeve ekonomike edhe para se të filloj transicioni, meqenëse vendet komuniste e përcaktonin tregtinë kryesisht nga vendimet politike. Çrregullimet u bënë më të theksuara gjatë transicionit fillestar (emergjent), i cili më tutje e ngriti nevojën për zbatimin e programeve të rregullimit strukturor. Në ballë të këtyre programeve për ndihma ishte FMN duke u ofruar kredi vendeve që ishin në krizë. Fillimisht, programet ishin përqendruar në disiplinën fiskale, uljen e inflacionit, reformat strukturore, dhe rritjen ekonomike.⁶ Deri në çfarë përmasash këto programe (të cilat llogariten si pjesa më e madhe e Konsensusit të Uashingtonit) ishin të suksesshme, përvoja nga EQL ofron rezultate të ndryshme. Përderisa kishte dhe ende ka kritika rreth këtyre programeve të FMN-së, një gjë ishte e sigurtë: ekonomitë e transicionit kishin nevojë për ndihmën e jashtme të perëndimit për zbatimin e reformave ekonomike me qëllim që ta tejkalojnë krizën në të cilën ishin futur pas rënies së komunizmit.

2.1. Transicioni i vështirë dhe kostoja më e lartë e tij: ndikimi i luftërave qytetare

Rënies së komunizmit në EQL si model politik dhe ekonomik mund t'i atribuohen disa shkaqe. Në përgjithësi, mund të konstatohet se lufta e gjatë e BRSS-së në Afganistan për ta mbështetur komunizmin që nga 1980 dhe tërheqja më 1989, i ka kontribuar shumë rënies së komunizmit. BRSS nuk ishte më në gjendje të ushtroj kontroll të drejtpëdrejtë në shtetet satelite të tij në EQL, siç bëri më herët në Revolucionin Hungarez më 1956 dhe në ish-Çekosllovakia më 1968. Më në fund, edhe vetë BRSS kishte probleme të brendshme dhe u shpërbë në 15 shtete të reja të pavarura, dhe u pajtua që ish-shtetet satelite në përendim të tij (në EQL) mund ta zgjedhin drejtimin e tyre të veçantë politik dhe ekonomik. Në shumicën e vendeve, kjo zgjedhje nuk ishte e lirë ose pa ngarkesa nga faktorët të cilët ishin përtej kapaciteteve për kontrollin e tyre dhe vështirësimin e transicionit ekonomik – luftërat qytetare.

Fillimi i viteve 1990-ta ishte periudhë e trazirave të përgjithshme në EQL ose në atë që njihet si “Blloku Lindor” i vendeve komuniste. Transicioni mund të merret se ka filluar që nga rënia e

⁶ International Monetary Fund (1997), “World Economy in Transition: Experience under the IMF’s Enhanced Structural Adjustment Facility”, Washington D.C., IMF Policy Development and Department of Review.

Murit të Berlinit në nëntor 1989, ngjarje e cila solli ribashkimin e Gjermanisë një vit më vonë, pastaj shpërbërjen e pushtetit të partive komuniste dhe krijimin e pluralizmit politik, reformat masive ekonomike me theks të posaçëm në transformimin dhe privatizimin e pronës shtetërore. Këto ndryshime sistemore u përcollën me kosto të lartë sociale në shumicën e vendeve, siç ishte shpërbërja e dy shteteve federale, asaj Sovjetike dhe Jugosllave, dhe krijimi i shteteve të reja të pavarura, si dhe ndarja e Çekosllovakisë. Përderisa kjo e fundit u nda në dy shtete në mënyrë paqësore në Republikën Çeke dhe Sllovaki, shpërbërja në BRSS dhe në Jugosllavi u përcoll me luftëra qytetare të kushtueshme. Ndonëse BRSS fillimisht e zbatoj zgjidhjen paqësore sikur të Çekosllovakisë, lëvizjet e mëtëjme separatiste dhe secesioniste shpërthyen në shumë pjesë të shteteve të sapokrijuara. Armenia dhe Azerbejxhani veç ishin në konflikt të armatosur rreth krahinës Nagorno Karabah që nga viti 1988, i cili u intensifikua pas pavarësisë së tyre pasi të dyja vendet po i formonin ushtritë e tyre, dhe armiqësitë zgjatën deri më 12 maj 1994. Afër tyre ose në rajonin e Kaukazit, ndodhi konflikti i armatosur në Gjeorgji ndërmjet qeverisë së saj dhe separatistëve pro-rusë në krahinën e Abhazisë dhe Osetisë Jugore (1992-1003, dhe më 1998), pastaj, dy luftëra në Çeçeni (e para nga dhjetori 1994 deri në gusht 1996, dhe e dyta nga gushti 1999 deri në maj 2000), me ndikime anësore në republikat dhe krahinat fqinje. Më tutje në lindje të Kaukazit ose në Azinë qendrore, ishte lufta qytetare në Taxhikistan (1992-1997), dhe separatizmi ruso-ukrainas në Molldavi. Shpërbërja më e përgjakshme ndodhi në ish-Jugosllavi nga 1991 deri më 1999 duke përfshirë krime të luftës dhe spastrim etnik. Të gjitha këto luftëra dhe konflikte të armatosura gjatë viteve 1990-ta, përveç humbjeve materiale, i kanë zvogëluar potencialet njerëzore, shumica e të cilave e zgjodhën emigrimin në kërkim të një jete dhe perspektive më të mirë. Në këtë skenar, do të ishte gabim të adresohet dështimi apo vështirësia e transicionit tek reformat ekonomike të bazuara në Konsensusin e Uashingtonit. Një numër i konsiderueshëm i njerëzve i braktisën vendet e tyre edhe pas rindërtimit dhe stabilizimit, dhe ata vazhdojnë të emigrojnë edhe në vitet mëvonshme. A ndodhi kjo për shkak se reformat e rekomanduara nga Konsensusi i Uashingtonit nuk ofruan perspektivën e nevojshme? Është shumë herët të thuhet në këtë fazë të diskutimit. Të shohim treguesin për popullsinë dhe koeficientin e Ginit në periudha të ndryshme.

Tabela 1: Popullsia dhe koeficienti i Ginit në vendet e Ballkanit Perëndimor

Vendet	Popullsia (në milion)*			Koeficienti i Ginit	
	1990	2007	2018	2002 ^{a)}	Vlerësimi i ri ^{b)}
Shqipëria	3.26	2.95	2.87	0.29	0.29 (2012)
Bosnia dhe Hercegovina	4.36	3.80	3.51	n/a	0.33 (2007)
Kroacia	4.78	4.40	4.10	0.35	0.32 (2014)
Kosova	1.96	2.10	1.80	n/a	0.26 (2016)
Macedonia e Veriut	2.02	2.01	2.07	0.27	0.36 (2015)
Mali i Zi	0.65	0.70	0.62	0.37	0.32 (2015)
Serbia	7.61	7.50	7.00	0.37	0.29 (2013)

* Përfshinë censusin (regjistrimin) dhe vlerësimet për vite të ndryshme nga zyrat e statistikës të vendeve përkatëse.
n/a = nuk ka të dhëna.

Burimi:

a) Sukiassyan, Grigor (2007), "Inequality and Growth: what Does the Transition Economy Data Say?", *Journal of Comparative Economics*, Vol. 35, No. 1, pp. 35-56, table 3, *op. cit.*

b) World Bank, Gini Index, gjendet në faqen: <https://data.worldbank.org/indicator/SI.POV.GINI/>, vizituar në janar 2019.

Që nga viti 1990, numri i popullsisë duket se ka rënë, së pari si rezultat i luftërave qytetare, e pastaj prej vitit 2007 e tutje kryesisht përmes emigrimit për shkaqe ekonomike. I vetmi vend i cili ka pëërjetuar rritje të vogël në numrin e popullsisë nga 1990 deri më 2018, është (tani) Maqedonia e Veriut por vetëm për disa dhjetëra mijëra banorë. Rënia e numrit të popullsisë është më interesante prej vitit 2007 deri më 2018, për shkak se, për një periudhë më të shkurt se nga 1990 deri më 2007, ajo u zvogëluar më shumë gjatë kohës së paqes. Dy kolonat e fundit nuk ofrojnë ndonjë tregues të mirëfillt për pabarazinë e të ardhurave siç matet me koeficientin e Ginit meqenëse të dhënat e plota mungojnë, dhe ato çka janë në dispozicion, janë kohë pas kohe. Deri në çfarë përmasash politika e reformave të zbatuara i ka kontribuar rritjes apo zvogëlimit të pabarazisë në të ardhura, nuk mund të sqarohet. Në nëntitullin e katërt të këtij punimi do t'i referohemi dhe sqarojmë burimet qeveritare siç janë normat e tatimeve të cilat ndikojnë në pabarazinë e të ardhurave, ndërkaq vlerësimet aktuale për koeficientin e Ginit nëpër vendet në shqyrtim mbesin të mëtejshme për hulumtime në të ardhmen.

2.2. Sqarimi për dëshmtimet e Konsensusit të Uashingtonit

Çka do të rekomandonte dikush për një ekonomi ekonomi komuniste e cila përballet me mungesa, duke përfshirë edhe artikujt ushqimorë? Kjo ishte një ndër arsyet kryesore pse një ekonomi e hapur e tregut ishte parapëlqyer nga politikë bërësit kur u përballen me dilemën se si të reformohet ose çfarë rruge të zgjidhet. Konsensusi i Uashingtonit ishte një rrugë ideale me ndjenjën emocionale se në një kohë ndoshta do të rezultoj në liri, demokraci dhe zhvillim ekonomik. Duke e transplantuar sistemin e rregullave tjetërkund, nuk mund të shpie në dukuri të ngjashme për shkak të dallimeve historike, ekonomike dhe kulturore.

Befasia e radhës gjatë transicionit ishte roli i shtetit në ekonomi, dhe këtu, ata që rekomandonin qasjen graduale duket se fitojnë në parashikimin e tyre. Duke jetuar për decaenitë nën diktaturën komuniste, shumica e popullsisë e kanë ndier veten sikur ishin çliruar menjëherë nga dikush ose nga shteti, deri në atë masë sa që ata e neglizhuan rolin e shtetit në rrethanat e reja të sistemit të ri që ishte në formim e sipër. Institucionet për ekonomi të tregut ndikojnë shumë në performancë dhe kjo në mënyrë të drejtpërdrejtë pasqyrohet edhe në jetën e qytetarëve. Gjatë transicionit, ky rol u ndesh me neglizhencë ose vështirësi në përgatitjen dhe zbatimin e kornizës ligjore lidhur me sektorin privat dhe rregullimin e ndërmarrjeve publike. Politikat që e mbështesin themelimin e qëndrimit politik për qeverisje e kanë efektin e tyre tek partitë të cilat ndikohen nga reformat, e këto më tutje mund t'i pengojnë kushtet e përgjithshme për lehtësirat e të bërit biznes. Një sqarim për zhvillimin institucional është i bazuar në krijimin e stimulimeve gjatë periudhës së transicionit. Në disa vende, qeveria ishte e nxitur aktivisht ta përcjellë transicionin me një pjesëmarrje të gjerë në themelimin e ekonomisë së tregut duke siguruar të drejtat pronësore bazë dhe sundimin e ligjit për të gjithë. Në disa tjera, elita ishte kryesisht e preokupuar rreth të drejtave pronësore të saja nga ndërmarrjet shtetërore që do të privatizoheshin, përmes të cilave do të siguronte një fuqi ekonomike dhe politike për ta dominuar periudhën pas transicionit. Qeveritë në grupin e parë të vendeve bashkëvepruan me ndërmarrësit potencial në atë që Frye dhe Shleifer e quajtën si modeli i “dorës së padukshme”, përmes të cilit qeveria është mirë e organizuar, në përgjithësi jo e korruptuar, dhe relativisht mirëbërëse. Në grupin e dytë, qeveria është pak a shumë e dezorganizuar dhe me burokratë që veprojnë për interesat e tyre private.⁷

⁷ Frye, Timothy, and Shleifer, Andrei (1997), “The Invisible Hand and the Grabbing Hand,” *American Economic Review*, Papers and Proceedings, Vol. 87, pp. 354-358.

Për shkak të këtyre dy llojeve të qeverisjes, janë shfaqur edhe përvoja të ndryshme në ndërtimin e ekonomisë së tregut në vendet e transicionit. Entuziazmi fillestar ra gradualisht dhe u kthye në dëshpërim kur reformat dështuan t'i materializojnë pritjet. Pas një decenie e gjysmë, transicioni në përgjithësi i ka bërë njerëzit të pakënaqur për një numër të arsyeve. Guriev dhe Zhuravskaya të cilët e hulumtuan lumturinë e jetës në ekonomitë pas komuniste përmes të dhënave të ndryshme sekondare, konstatuan përfitime të konsiderueshme ekonomike pas vitit 1995 në kuadër të rritjes së konsumit familjar, banimit, veturave, dhe kompjuterëve personal në pronësi të tyre. Pasi shqetësime materiale ishin tejkaluar, pakënaqësia kaloj tek rritja e dallimeve në të ardhura e matur sipas koeficientit të Ginit, përkeqësimi i të mirave publike, rritja e pasigurisë, dhe zhvlerësimi i kapitalit njerëzor që dëshironte të emigroj për një jetë më të mirë.⁸ Transicioni në EQL pas një dezorganizimi dhe rënie ka rezultuar në arritjen e lirive qytetare dhe të mirave materiale më të mëdha në afat më të gjatë. Zhvillimi ekonomik dhe teknologjik global edhe ashtu do t'i sillte këto përfitimet materiale për jetesë. Ajo me të cilën shumë njerëz në EQL nuk janë aq të kënaqur, nuk është thjeshtë e lidhur me ekonominë, por tek padrejtësia, pasiguria, dallimi në të ardhura, dhe të mirat publike (sidomos kujdesi shëndetësor dhe arsimit) për të cilat ata duhet të paguajnë si konsumatorë tek biznesi. Kjo pakënaqësi është mirë e adresuar nga modeli evropian i ekonomisë sociale të tregut.

⁸ Guriev, Sergei and Zhuravskaya, Ekaterina (2009), “(Un)Happiness in transition”, *Journal of Economic Perspectives*, Vol. 23, No. 2, pp. 143–168.

3. Bazat dhe performanca a ekonomisë sociale të tregut

Ekonomia Sociale e Tregut (Soziale Marktwirtschaft) fillet e së cilës janë në Gjermaninë Perëndimore pas Luftës së Dytë Botërore (LDB) ishte bërë gjithnjë e më shumë model evropian. Para se të hyjmë në hollësira se çka përmban ose në çka bazohet, do të ishte e dobishme të diskutohen shkaqet e futjes në përdorim të saj, pasi kjo mund t'u ndihmoj politikë bërësve ekonomik të zgjedhin rrugë ose modele të zhvillimit në rrethana të caktuara (për dallim nga mungesa e teorive nga komunizmi në kapitalizëm). Pse Gjermania (Perëndimore) e pranoi këtë model dhe për çfarë qëllimi? Përgjigja duhet të kërkohej pak më herët në kronologjinë e ngjarjeve që ndodhën në Gjermani që nga Lufta e Parë Botërore (LPB).

Pas LPB-së Gjermania ishte në anën e humbësit, jo në frontet e luftës por pasi e nënshkroi armëpushimin. Territoret e mëdha që i kishte pushtuar dhe ende i kishte nën kontroll pas përfundimit të luftës në Lindje (Traktati i Brest-Litovskit), Belgjikë dhe pak në Francë, duhet të lëshoheshin, e madje edhe të humb disa pjesë të territorit të saj tek shtetet fqinje. Armëpushimin e përcolli kapitullimi dhe Traktati i Versajit, me kushte të ashpra kundër Gjermanisë. Ekziston një pajtim i përgjithshëm se Traktati nuk ishte asgjë më pak se sa garancion për një luftë të ardhshme (LDB). Sfidat për Gjermaninë e pas LPB ishin të vështira. E para, për kapitullimin e Gjermanisë, nga disa qarqe brenda ushtrisë së saj, u fajësua tradhëtia nga politikanët. E dyta, kushtet e ashpra kundër saj për pagesën e reparacioneve (dëmshpërblimeve), dalja në skenë e anarkistëve, komunistëve, së bashku me krizën e madhe ekonomike, e krijoj besimin se një shtet i centralizuar i fortë duhet të jetë i nevojshëm për t'iu kundërvënë kërcënimit të komunizmit sovjetik. E treta, Depresioni i Madh 1929-33 u bë dëshmi plotësuese për nevojën e një shteti të centralizuar. E katërta, periudha e shkurtë brenda së cilës nazistët e kthyen Gjermaninë nga papunësia masive në mungesë të fuqisë punëtore, e krijoj bindjen se ky qenka modeli që duhet zbatuar ndaj krizës ekonomike, por meqenëse shkoj shumë larg në ekspansionizëm përtej kufinjve shtetëror duke e eksploatuar fuqinë punëtore skllave për qëllime të luftës, përfundoj në pasojat katastrofike. Gjermania gjendej në rrënoja pas LDB-së dhe ishte okupuar nga Aleatët. Si të bëhëj Gjermania ekonomikisht e fortë edhe një herë kur i tërë populli thuajse ishte shkatërruar? Çfarë modeli të zhvillimit ekonomik duhej ndjekur? Sikur atë nën regjimin e nazistëve? Jo më tutje. Mirëpo, ekzistonte një alternativë ekonomike me të njëjtin qëllim sikur ai i nazistëve derisa bëhej

distancimi prej tyre – Ekonomia Sociale e Tregut – për ta bërë Gjermaninë përsëri të fortë ekonomikisht. Si mund të arrihej kjo?

Ekonomia Sociale e Tregut është model ekonomik kapitalist i veçantë, përkundër se i ka shumë veti të përbashkëta me modelin amerikan. Në këtë kuptim, ky model e ka zhvilluar qasjen e vet pothuajse në të gjitha dukuritë ekonomike, pavarësisht se sa të ndryshme apo të ngjashme me modelet tjera, duke përfshirë edhe transicionin nga komunizmi në kapitalizëm që është i rëndësishëm për këtë punim. Së pari, le t'i përmbledhim parime bazë të këtij modeli në të cilat bazohet, nja 10 prej tyre për krahasim me Konsensusin e Uashingtonit.⁹

- 1) Model ekonomik kushtetues, koncepti i të cilit është përkufizuar nga shteti duke e bërë atë të detyrueshëm;
- 2) Roli aktiv i shtetit në ekonomi për t'i përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të veprj si rregullator;
- 3) Planifikimi ekonomik në nivel kombëtar përmes politikave qeveritare dhe orientimi në zhvillim;
- 4) Zgjedhja e lirë ndërmjet veprimtarive ekonomike dhe konkurrenca;
- 5) Roli në vendim marrje në nivelin mikroekonomik për ta parandaluar eksploatimin e jashtëligjshëm por edhe zyrtar të punëtorëve;
- 6) Shpërndarja e të ardhurave ku shteti luan rol të tërthortë në rishpërndarje;
- 7) Të drejtat pronësore dhe privatizimi, ku modeli bazohet kryesisht në pronën private, kurse privatizimi i ndërmarrjeve publike vie në shprehje pasi të jetë siguruar konkurrenca për ta shmangur monopolin dhe diskriminimin në çmime;
- 8) Tregtia ndërkombëtare liberale në përputhje me sundimin e ligjit;
- 9) Programet e mirëqënies sociale (sigurimi shëndetësor, arsimimi dhe hulumtimi shkencor) për të ofruar mundësi të barabarta përmes financimit shtetëror për të gjithë në lëmitë përkatëse të ekonomisë;
- 10) Tatime më të larta ndaj bizneseve për t'i mbështetur programet e mirëqënies sociale.

⁹ Për më tepër rreth parimeve të ekonomisë sociale të tregut, shih në mes tjerëve, Esderts, Hans, J. (2003), *Easy Guide to Social Market Economy*, Bahasa: Friedrich Ebert Stiftung; dhe Hasse, Rolf, H., Hermann, Schnedier and Weigelt, Klaus eds, (2008), *Social Market Economy, Principles and Implementation – From A to Z*, Paderborn: Verlag Ferdinand Schöningh.

Një nga fushat kyçe ku modeli evropian dallon prej atij amerikan, dhe kjo u vërtetua si shumë e rëndësishme kur iu referuam përvojës së vendeve pas komuniste, është roli i shtetit në ekonomi.¹⁰ Ka qenë kjo ndjenjë e rolit të vogël ose të pa koordinuar që ka shpër deri te shumë dështime gjatë transicionit. Modeli evropian kishte një pikëpamje më të mirë mbi rolin e shtetit në ekonominë e tregut, por siç e theksuam më herët, publiku i gjerë ishte ngopur me të nën diktaturën komuniste, pas të cilit emocionalisht kaloi në një lloj lirie të pakontrolluar. Një tjetër parim kyç që i dallon dy modelet perëndimore lidhur me ekonominë e transicionit është qasja e tyre ndaj privatizimit. Modeli evropian e mbështet privatizimin gradual të ndërmarrjeve shtetërore dhe publike duke e marrë për bazë së pari konkurrencën dhe kontrollin ndaj monopoleve, kurse modeli amerikan është në favor të privatizimit të shpejtë si udhërrëfyes që do të sjellë konkurrencën. Tjetri ndryshim me radhë i rëndësishëm por jo i fundit, është bashkëveprimi i parimeve 6) dhe 10) të cekura më lartë, respektivisht në tatime dhe shpërndarjen e të ardhurave. Modeli amerikan rekomandon që normat tatimore të mbahen relativisht të ulëta për t’iu dhënë më shumë mundësi bizneseve edhe nëse këto evoluojnë në monopole, përderisa modeli evropian dëshiron t’i tatimoj më shumë bizneset fitimprurëse dhe ta bëjë rishpërndarjen e të ardhurave në mënyrë të tërthortë tek pjesa tjetër e popullsisë. Këto dallime janë bërë temë e interesimit, me vërejtjen në Ballkanin Perëndimor se ende ekzistojnë modele alternative ndaj Konsensusit të Uashingtonit, dhe ai është në dispozicion tek pragu i derës ku synon të integrohet – modeli evropian i ekonomisë sociale të tregut.

¹⁰ Termi model amerikan nuk duhet të ngatërrohet me Konsensusin e Uashingtonit, përkundër se i dyti u derivua si rekomandim nga i pari. I dyti është i lidhur me rekomandimet e politikave për vendet e transicionit, por ende është një pasqyrë e përgjithshme e të parit. Sidoqoftë, të dyja janë përdorur si sinonime për qëllimin e këtij punimi, siç është rasti edhe me ekonominë sociale të tregut si model evropian i cili ndryshon dhe nuk zbatohet në të gjitha vendet evropiane.

3.1. Bashkëveprimi ndërmjet politikës dhe ekonomisë: Konsensusi i Uashingtonit kundrejt Ekonomisë Sociale të Tregut

Konsensusi i Uashingtonit ose modeli amerikan nuk është vetëm për ekonominë; ai gjithashtu ndikon edhe në politikë me synimin e mbrojtjes dhe sundimit të ekonomisë. Në këtë bashkëveprim ndërmjet politikës dhe ekonomisë, mund ta vërejmë dallimin ndërmjet modelit amerikan dhe evropian, i cili në mes tjerash mund të haset në zgjedhjen e kryesuesit të shtetit, respektivisht kryetarit dhe/ose kryeministrit. Tradicionalisht, kryetarët e SHBA-së kanë ardhur nga sfondi i fuqishëm i biznesit (si për shembull Donalld Tramp, kryetar i tanishëm) ose ata të cilët nuk e kishin këtë prapavi, ende ishin në ballë ose prapa bizneseve të mëdha dhe miliarderëve. Ky është shembull se si biznesi e formëson politikën në SHBA.

Në Evropë, kjo marrëdhënie ndërmjet ekonomisë dhe politikës është e ndryshme. Rrallë herë ka ndodhur që një kryeministër i ndonjë vendi të BE-së të jetë biznismen i fuqishëm. Më i theksuari ndër ta ka qenë Silvio Berlusconi në Itali, i cili edhe ashtu u bë kundërthënës. Të tjerët ishin dhe ende janë me prapavi ndryshe nga biznesi, duke filluar nga Angela Merkel (kancelarja e Gjermanisë), Emanuel Makro (Francë), Tereza Mej (Mbretëri e Bashkuar), Xhuzepe Konte (Itali), e kështu me radhë. Këta as që erdhën nga ndonjë prapavi e pasur në biznes, e as që u bënë të tillë përmes politikës pasi u skadoj mandati ose u pensionuan; ata mbesin të “varfër” nga perspektiva e biznesit të tyre. Për dallim nga këta ose në të kundërtën, në Ballkanin Perëndimor, sidomos në Shqipëri, Bosnjë, Kosovë, dhe Maqedoni të Veriut, politikanët pasi vijnë në pushtet politik tentojnë qoftë vetë ose përmes shokëve dhe të afërmëve të tyre ta rrembejnë mundësinë për pasurimin e vetes me praktika diskriminuese dhe shpesh të kundërligjshme. Madje, disa prej tyre nuk do të dëshironin të qëndrojnë më tutje në pozita politike nëse janë shpague sa duhet me pasurinë të cilën e kanë siguruar përmes politikës, për shkak se kjo u mundëson atyre ta kenë pushtetin e vërtetë ekonomik ndaj politikanëve. Ky është transicion drejt modelit amerikan, i cili merr më shumë kohë dhe rezultatet e përgjithshme të tij janë të pasigurta. Para së gjithash, derisa premtimi i modelit amerikan e parasheh një skenar të tillë ose sundimin e politikës nga biznesi që duhet të ndodhë në të ardhmen, pjesa më e madhe e BE-së ka shkuar në një fazë më të përparuar kurse vendet e Ballkanit në shqyrtim janë duke e formësuar zbatimin e modelit amerikan i cili po e detyron popullsinë të emigroj në numër të madh, krejsisht për në Gjermani.

Për ta mbajtur mirëqënien sociale, Ekonomia Sociale e Tregut duhet të mbështetet në ngarkesën mesatarisht më të lartë me tatime ndaj bizneseve, kryesisht në rritjen progresive të normave tatimore kundrejt korporatave fitimprurëse, kështu që, ajo mund ta plotësojë kërkesën për ofrimin e mundësive shtresave të varfëra në sektorë të ndryshëm, shumica prej të cilave nuk e mbështesin drejtpërdrejt rritjen ekonomike (kujdesi shëndetësor, arsimimi, sporti). Në këtë mënyrë, bizneset në modelin evropian pritet të kenë më pak burime ose fonde për hulumtim dhe zhvillim, investime, rritje dhe zgjerim pasi që një pjesë e madhe e fitimit të tyre shkon për shtetin i cili e shfrytëzon atë ndryshe. Në anën tjetër, pritet për bizneset në modelin amerikan janë që ato kanë në dispozicion të tyre më shumë mjete për hulumtim dhe zhvillim, kështu që ato bëhen më inovative dhe më konkurrense në përgjithësi. Është pikërisht ky dallim pse disa ekonomistë gjermanë si Seliger dhe Wrobel rekomanduan se modeli amerikan është më i mirë për rritje dhe zhvillim të Gjermanisë, tash e tutje.¹¹ Konstatimi i tyre lë përshtypjen se modeli gjerman (deri diku po ashtu edhe e i BE-së) i ekonomisë sociale të tregut mund të jetë i parapëlqyer deri në një far shkalle ose derisa përfituesit e mirëqënies sociale të shtetit bëhen përtacë duke u mësuar të konsumojnë të mirat e të tjerëve ose ato të cilat nuk i kanë krijuar vetë. Një supozim i tillë rreth superioritetit të modelit amerikan, sidomos kundrejt modelit të pastër gjerman, duhet të testohet me studime më të hollësishme empirike, në mes tjerash, të testohet hipoteza: nëse modeli amerikan është më i shpejt, bëhet më inovativ (zbulues) dhe më konkurrent, atëherë a do të shpien në perspektivë nëse nuk e mbështet aktivisht pjesën tjetër të popullsisë për tregun e punës pasi që Gjermania shkon përmes programeve të aftësimeve profesionale dhe arsimimit pa pagesë? Në Gjermani, personi jo produktiv ose i pa aftë përgatitet për tregun e punës dhe në ekonomi përmes programeve shtetërore të mirëqënies sociale. Alternativa amerikane ndaj kësaj pyetjeje është më e thjeshtë dhe funksionon në mënyrë më efikase; SHBA-të tërheqin dhe importojnë punëtorë të shkathtë dhe profesionistë nga e tërë bota. Pse të shpenzohen burimet kombëtare të përmasave sikur në modelin Gjerman për aftësim kur ne mund t'i marrim ata njerëz të gatshëm nga jashtë, dhe t'i lëmë bizneset tona me më shumë fitim në dispozicion për zbulime dhe zhvillim të mëtejshëm, do të ishte përgjigja e modelit amerikan.

¹¹ Seliger, Bernhard and M. Wrobel, Ralph (2007), "Die Krise der Ordnungspolitik als Kommunikationskrise", (*The Crisis of Economic Order Policy as a Crisis of Communication*), Discussion Paper No. 1, First Dialogue on Social Market Economy: The Social Market Economy Concept and its Implications, Zwickau, 29-30 November 2007.

Në qendër të ideologjisë politike lidhur me zhvillimin ekonomik në SHBA ndërmjet partisë demokratike dhe republika është rivaliteti i tyre, i cili gjithmonë e ka mbajtur baraspeshën në përgjigje të rrethanave ekonomike. Historikisht, të dyja partitë, duke përfshirë edhe Kryetarin me pushtet të ngjashëm me atë të mbretit, kanë ardhur në pushtet dhe janë larguar nga pushteti varësisht se si ka rrjedhur dhe si është situata ekonomike. Demokratët të cilët pak a shumë janë parti e majt me ideologji të ngjashme sikur të modelit të BE-së, përcjellin qasje të ngjashme meqenëse janë më shumë të orientuar kah politikën sociale se republikanët. Nëse dallimet në të ardhura në SHBA rriten më shumë, atëherë mund të jetë koha për ta favorizuar dhe votuar për Kryetar dikë nga kampi demokrat. Meqenëse demokratët janë më tepër të orientuar kah politikën sociale sikur në modelin gjerman por në shkallë më të ultë, kur vërehet se sistemi po e merr një barrë sociale që u ofrohet “parazitëve” ose sistemi po rrëshqet drejt “përtacisë”, atëherë duhet të sillen republikanët në pushtet për ta ripërtërirë agjendën e tyre të reformave por pa e ndryshuar sistemin. Ky është vetëm një parim ideologjik i cili në zgjedhjet e SHBA-së jo domosdoshmërisht zbatohet gjatë tërë kohës ndërmjet dy partive – demokratike dhe republikane.

4. Ballkani Perëndimor ende është në transicion; Ekonomia Sociale e Tregut është model më i mirë

Mungesa e teorive mbi transicionin nga komunizmi në kapitalizëm ishte një prej arsyeve kryesore të befasisë nga transicioni. Kanë ekzistuar teori të transicionit nga kapitalizmi në komunizëm, por jo aq shumë në drejtim të kundërt ose anasjelltas derisa komunizmi u dobësua seriozisht, si politikisht ashtu edhe ekonomikisht. Si për ironi, në ish-Jugosllavi, në ditët e arta të komunizmit jo zyrtarisht ishte zbuluar parulla popullore “Amerika i Engleska biçë zemlje proleterska (Amerika dhe Anglia do të bëjnë vende proletare)”, me bindjen sikur komunizmi do të ishte sistem i përjetshëm. Kjo ka qenë e mjaftueshme për disa ose shumicën të mos mendojnë ndonjëherë për braktisjen e tij dhe ta përqafojnë sistemin amerikan ose anglez në vend të tij. Madje, ata (në ish-Jugosllavi) nuk kanë qenë aq të etur ta përqafojnë ndonjë ndryshim radikal ekonomik derisa shpërthyen luftërat civile, duke rezultuar në ndryshime më radikale në të gjitha aspektet e shoqërisë. Sllovenia u nda nga Jugosllavia pas 10 ditëve luftë dhe nuk është pjesë e asaj që ne e përkufizojmë si Ballkani Perëndimor. Në Kroaci (1991-95) dhe Bosnjë e Hercegovinë (1991-95)

ka pasur shkatërrime më të mëdha, humbje të popullsisë (vetëm në Bosnjë mbi 100 000 të vrarë dhe 2 milionë të zhvendosur) dhe spastrim etnik. Shqipëria po ashtu përjetoi një lloj lufte qytetare më 1997. Fqinji i saj Kosova që ishte pjesë e Jugosllavisë po ashtu e përjetoi luftën, shkatërrimin dhe zhvendosje masive të popullsisë më 1999. Për shkak të hapësirës dhe kontekstit, nuk do t'i diskutojmë ngjarjet politike dhe ekonomike të këtyre vendeve. Ndoshta, me rëndësi më të madhe është se çfarë reformash ekonomike i kanë në fuqi, nga të cilat ne i kemi zgjedhur normat e tatimeve duke u përqendruar në Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatimin në të Ardhurat Personale (TAP) dhe Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (TAK).

Tabela 2: Normat e tri tatimeve kryesore në Ballkanin Perëndimor (në %) më 2018

Vendet	TVSH*	TAP**	TAK
Shqipëria	20	23	15
Bosnia e Hercegovina	17	10	10
Kroacia	25	36	18
Kosova	18	10	10
Maqedonia e Veriut	18	10	10
Mali i Zi	21	9	9
Serbia	20	10	15
Gjermania	19	47	30
SHBA	0	37	21

*Përfshinë vetëm normat standarde për shumicën e produkteve dhe shërbimeve, jo edhe normat e diferencuara ose të zbritura që zbatohen për disa artikuj ushqimorë dhe të mjekësisë.

** Norma më e lartë, duke përfshirë kalsifikimin e normave më të ulëta sipas sipas nivelit të të ardhurave.

Burimi: Faqet e qeverive të përmbledhura në: <https://tradingeconomics.com/>, vizituar në shkurt 2019.

Treguesit në Tabelën 2 nuk mund ta tregojnë pasqyrën më të gjerë të modelit ekonomik, por ata ndihmojnë shumë në kuptimin se çfarë qëllimi kanë dhe çfarë rezultatesh ka gjasa të prodhojnë në ekonomi. TVSH, në disa vende i njohur si tatimi në shitje, është tatimi dhe kontribuesi kryesor i buxhetit të shtetit për thuajse të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Ka normë relativisht më të lartë se TAP dhe TAK, dhe është kryesisht tatim në konsum të cilin duhet ta paguajnë qytetarët. Norma e tij më e lartë së bashku me normat e ulëta të TAP dhe TAK do të

thotë se shumica e popullsisë duhet t'i paguajnë më shumë shtetit në baza ditore, ndërkaq korporatat ose të pasurit i kanë normat e tyre të tatimeve më të ulëta. Kjo është një nga burimet kryesore të pabarazisë në të ardhura, ose ajo që imponohet nga shteti për t'i bërë të pasurit më të pasur siç e pret Konsensusi i Uashingtonit për të lejuar më shumë liri për bizneset që ta vazhdojnë rritjen e tyre në kurriz të dikujt tjetër që paguajnë TVSH. Siç e kemi theksuar në shqyrtimet teorike duke i krahasuar parimet e modelit amerikan dhe atij gjerman, nga Tabela 2 mund ta vërejmë se Gjermania ngarkon norma më të larta në TAP dhe TAK, dhe më të ulëta në TVSH (madje më të ulëta se në katër prej shtatë vendeve në Ballkanin Perëndimor) se në SHBA. TAK në Gjermani është 30% krahasuar me 21% në SHBA, çka është në përputhje me konceptin bazë të dy modeleve lidhur me tatimet. TAP është gjithashtu më i lartë në Gjermani se në SHBA, respektivisht 47% kundrejt 37%.

Në këtë mënyrë, dallimi në koncepte ndërmjet modelit amerikan dhe evropian ose gjerman është i manifestuar edhe nga fuqizimet ligjore të tyre në politikat ekonomike, ku shembulli më i theksuar është në normat e tatimeve. Duke shikuar normat e tatimeve që janë në fuqi në Ballkanin Perëndimor, mund të theksohet se këto vende ende janë duke i zbatuar reformat që i përshtaten rekomandimeve të Konsensusit të Uashingtonit, përkundër dëshirës së tyre dhe procesit për t'iu bashkuar BE-së. Rezultati i një politike të tillë nuk është problem i rritjes së pabarazisë në të ardhura e cila në SHBA mund të shpie te rritja ekonomike më e madhe, por te emigrimi. Në një kohë, popujt e ish-Jugosllavisë e lëshonin vendin e tyre për shkak të pasigurisë (luftërat qytetare të viteve 1990-ta) për në vendet e zhvilluara të perëndimit, por tani shumica dërrmuese e tyre e lëshojnë pasi modeli i tyre i zhvillimit ekonomik nuk i përmbushë kërkesat e tyre, ose ata janë të pakënaqur me të.

Përmbyllje dhe implikimet

Vendet pas komuniste në EQL, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor, kanë kaluar përmes një periudhe të ndryshimeve sistemore politike dhe ekonomike. Sidomos në rastin e dytë, ky transicion ishte dramatik, i cili përkoj me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë dhe krijimin e shteteve pasardhëse. Pakoja e reformave e zbatuar në pjesën tjetër të EQL e njohur si Konsensusi i Uashingtonit, ishte futur në përdorim edhe në këtë pjesë të Evropës. Sipas gjendjes së decenies së dytë të shekullit XXI, rezultatet janë të paqarta meqenëse në njërin anë kanë ndikuar në rritje ekonomike dhe zhvillim, por në anën tjetër kanë shkaktuar çrregullime strukturore. Në mes tjerash, reformat e zbatuara nga shteti për një ekonomi të hapur tregu janë duke shkaktuar krijimin e një klase ekonomike dhe politike gjersa i shtyen shumicën e të tjerëve në varfëri dhe duke i detyruar ata ta lëshojnë vendin e tyre në kërkim të një jete dhe mirëqënie ekonomike më të mirë. Ata duket se janë të pakënaqur me modelin ekzistues i cili favorizon një pakicë në kurriz të shumicës në këtë pjesë të Ballkanit e cila ende është burim i konflikteve të mundshme.

Disa madje mund ta mbajnë qëndrimin se tani është vonë të fillohet ose reformohet me një model tjetër të zhvillimit ekonomik përveç atij që Ballkani Perëndimor e ka provuar për më shumë se dy decenie. Mirëpo, ekzistojnë dy aspekte vendimtare në të cilat këto vende duhet të lëvizin me reformat ekonomike, e kjo arrinë tek braktisja e modelit amerikan në favor të atij evropian. Së pari, siç sygjeron diskutimi dhe disa tregues nga ky punim, këto vende ende janë duke e zbatuar pakon e reformave nga Konsensusi i Uashingtonit, dhe rezultatet e vështruara gjerë më tani janë siç pritej, duke devijuar deri-diku nga kërkesat dhe realiteti i BE-së. Së dyti, kjo pjesë e Evropës, me përjashtim të Kroacisë, është komplet e rrethuar nga vendet anëtare të BE-së, dhe në të ardhmen e afërt pritet t'i bashkangjitet asaj. Edhe pse pranon shumë mbështetje nga BE si pjesë e aderimit dhe anëtarësimit në të, është duke i udhëhequr reformat që nuk janë aq shumë në frymën e modelit evropian. Për të qenë më shumë në përputhje me modelin evropian, qeveritë në Ballkanin Perëndimor duhet t'i reformojnë tatimet e tyre duke e zvogëluar normën e TVSH-së dhe duke e rritur atë për TAP dhe TAK. Politikëbërësit do të ankohen se një veprim i tillë duke imponuar tatime më të larta i kufizon investimet si vendore ashtu edhe të huaja. Megjithatë, këto janë vende të vogla, popullsia e së cilës gradualisht po tkurret përmes emigrimit. Këto nuk kanë kohë të kalojnë përmes rrugës amerikane të zhvillimit, për shkak se SHBA është vend i madh dhe i zhvilluar me ndikim mbarë botëror. Modeli amerikan nuk përshtatet dhe nuk mund të funksionoj

si duhet në Ballkanin Perëndimor, ose nëse funksionon, performanca e tij është ndoshta më e varfër në përmasa të përgjithshme se e Ekonomisë Sociale të Tregut. Bizneset nga Ballkani Perëndimor do ta kenë të vështirë të bëhen konkurrencte në përmasa mbarë botërore sikur korporatat amerikane, edhe nëse ato janë të stimuluar me norma shumë të ulëta të tatimeve.

Referencat

Aslund, Anders (2000), “The Myth of Output Collapse after Communism”, Washington D.C.: Carnegie Endowment for International Peace.

Esderts, Hans, J. (2003), Easy Guide to Social Market Economy, Bahasa: Friedrich Ebert Stiftung.

Fisher, Stanley and Sahay, Ratna (2000), “The Transition Economies after Ten Years”, Cambridge: National Bureau of Economic Research, Working Paper No. 7664.

Frye, Timothy, and Shleifer, Andrei (1997), “The Invisible Hand and the Grabbing Hand,” *American Economic Review*, Papers and Proceedings, Vol. 87, pp. 354-358.

Guriev, Sergei and Zhuravskaya, Ekaterina (2009), “(Un)Happiness in transition”, *Journal of Economic Perspectives*, Vol. 23, No. 2, pp. 143–168.

Havrylyshyn, Oleh (2007), “Fifteen Years of Transformation in Post-Communist World: Rapid Reformers Outperformed Gradualists”, CATO Institute, Discussion Paper No. 4.

International Monetary Fund (1997), “World Economy in Transition: Experience under the IMF’s Enhanced Structural Adjustment Facility”, Washington D.C., IMF Policy Development and Department of Review.

Rolf, H., Hermann, Schnedier and Weigelt, Klaus eds. (2008), *Social Market Economy, Principles and Implementation – From A to Z*, Paderborn: Verlag Ferdinand Schöningh.

Seliger, Bernhard and M. Wrobel, Ralph (2007), “Die Krise der Ordnungspolitik als Kommunikationskrise”, (*The Crisis of Economic Order Policy as a Crisis of Communication*), Discussion Paper No. 1, First Dialogue on Social Market Economy: The Social Market Economy Concept and its Implications, Zwickau, 29-30 November 2007.

Stiglitz, Joseph (2002), *Globalization and Its Discontents*, London: Penguin Books.

Sukiassyan, Grigor (2007), “Inequality and Growth: what Does the Transition Economy Data Say?”, *Journal of Comparative Economics*, Vol. 35, No. 1, pp. 35-56.

Williamson, John (1990), “What Washington Means by Policy Reform?”, in Williamson, John ed., *Latin American Adjustment: How Much has Happened?*, Washington DC.: Institute for International Economics.

World Bank, Gini Index, available at: <https://data.worldbank.org/indicator/SI.POV.GINI/>, accessed on January 2019.